

Syllabusi i lëndës

Lënda: Stili i Shkrimit akademik

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 105

Fondi i orëve: 2+1

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: i -I-rë

Mësimdhënësi: Prof. Ass..Dr.Rexhep Suma

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Lënda e Stilit të shkrimit akademik në fokus do të ketë rolin dhe misionin e thirrësit në fenë islame, metodologjinë dhe mesazhin në zbatimin dhe shtrirjen e ligjëratave të tij. Etika dhe morali i lartë që duhet të zotëroj thirrësi. Nevoja dhe domosdoshmëria që duhet të radhiten prioritet në misionin e tij dhe të prolongohen gjërat sekondare.

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kursit nga lënda “Stili i *Shkrimit akademik*” tu ofroj studentëve dije të avancuar teorike dhe eksperiencë në këtë fushë duke ofruar njohuri teorike lidhur me shkrimin akademik, veçantitë e tij, strukturën, llojet dhe mjetet shprehëse të tij. Puna në orët e lëndës (3 orë në javë) do të orientohet në përfitimin e dijes së sistemuar nga studentët, të cilët do të jenë pjesë aktive e procesit studimor, veçmas përmes punës në grupe. Puna në grupe do të ketë për qëllim të nxisë studentët për të krijuar qasje dhe qëndrime personale-kritike duke shprehur kështu edhe talentin e tyre intelektual përmes eseve, punimit të diplomave dhe punimit seminarik. Pra, ky kurs do t’iu ndihmojë studentëve që të ngrënë nivelin e leximit kritik të teksteve shkencore dhe të shprehën me një nivel të kënaqshëm akademik në shkrimet e tyre, si seminare, punime diplome etj. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu edhe metodat e analizimit dhe leximit të burimeve primare dhe sekondare në mënyrë që t’i përdorin ato sa më mirë gjatë dhe pas studimeve bachelor. Studentët do të mësojnë gjithashtu kriteret që përdoren për strukturimin e punimit dhe përdorimit me efikasitet të materialeve të grumbulluara prej tyre gjatë punës kërkimore. Kurse ky modul synon të aftësojë studentët që vetë të hulumtojnë dhe vlerësojnë dukuritë dhe fenomenet shoqërore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit studenti pritet të dijë, kuptoj ose të jetë në gjendje të:

- Të njohin nocionet dhe karakteristikat themelore të shkrimit akademik dhe hulumtimit në komunikime kundruall formave të zakonshme të shkrimit.
 - Të arrijnë të konceptojnë një shkrim akademik hulumtimi në komunikime në përputhje me veçantitë e tij strukturore.
 - Të zotërojnë teknikën e përdorimit të drejtë të referencave.
 - Të shkruajnë ese, punime seminarike dhe të diplomës bazuar në njohuritë e fituara teorike;
 - Të jetë në gjendje të analizoj dhe debatojë efektet shumëdimensionale të burimeve të ndryshme të informacionit në mënyrë korrekte.
 - Të menaxhoj në mënyrë praktikë më procesin e organizimit të një hulumtimi.
 - Të planifikoj dhe programojë punën praktike profesionale
- Të aftësohen për të bërë leximin kritik të teksteve universitare,
- Të aftësohen për të vlerësuar një tekst akademik,
 - Të aftësohen për të bërë leximin kritik të teksteve universitare,
 - Të aftësohen për të vlerësuar një tekst akademik,
 - Të zhvillojnë në nivel të kënaqshëm aftësitë shprehëse, teknikat e shkrimit akademik dhe hulumtimit në komunikime

Metodologjia e mësimdhënies:

Realizimi i mësimdhënies do të zhvillohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve nga lëmi i “Stili i shkrimit akademik”. Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, esetë, ushtrimet, diskutimet, puna në grupe dhe, për të gjitha këto, do të përdoren teknika dhe metodat e reja. Natyra e lëndës mundëson shumëllojshmëri qasjesh të mësimdhënies dhe strategjive të mësimdhënies. Nga ju kërkohet reflektim kritik dhe qasje refleksive për të zhvilluar të menduarit kritik. Çdo formë e paraqitur është e hapur për diskutim dhe modifikim përmes dakordimit të përbashkët.

- **Ligjërata** - Ligjëratat mbahen sipas orarit të publikuar në web faqe, www.fsi-edu.net. Inkurajoheni të jeni sa më aktiv dhe fleksibil si dhe të përfshirë në të gjitha detyrat që realizohen në klasë.
- **Ushtrimet praktike** – Pjesa e praktikës do të jetë demonstrim i njohurive dhe shkathtësive të përfituara në ligjëratë si dhe me hulumtimin që përcaktohet nga profesori dhe studenti paraprakisht në funksion të temës.
- **Punë individuale dhe detyra** - Gjatë realizimit të mësimit do të keni edhe detyra individuale për të përmbushur obligimet. Detyrat mund të përzgjedhë nga:
 - Plani i orës i përgatitur për të mbajtur orën praktike.
 - Analizë e planit të ndonjërit nga shokët e grupit tuaj.
 - Vlerësim i ndonjë pjese të strukturës së orës me analizë të thellë dhe sqarim për çështjet specifike.
 - Projekt hulumtimi i propozuar për nxënësit i propozuar sipas formatit të lëndëve për mësim zgjedhorë.
- **Punim seminarik** – Punimi i seminarit duhet të jetë i karakterit hulumtues dhe duhet të përmbajë elementet përbërëse të një hulumtimi. Kjo mund të realizohet në formë si hulumtim rasti, analizë e literaturës specifike, projekt.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjërata
1.	I	-Prezantim i përgjithshëm i përmbajtjen e syllabusit dhe çështjeve që ndërlidhën me përmbajtjes së lëndës - Veçantitë e shkrimit akademik kundruall formave të zakonshme të shkrimit
2.	II	Procesi i të shkruarit (Një historik i shkurtër mbi rëndësinë shumëdimensionale të procesit të shkruarit si formë e përcjelljes së ideve tek të tjerët...). Natyra e subjektit të kërkimit shkencor.
3.	III	Zhvillimi i ideve. (Leksion për zbulimin e ideve, pra edhe në fushat e komunikimit dhe zhvillimin e tyre, përmes procesit të shkrimit akademik dhe metodologjisë së hulumtimit. Pra, rruga deri te zbulimi, shtjellimi, interpretimi i ideve dhe pasqyrimi i tyre në formën e eseve akademike. Trajtim, tipik shkencor nga metodologjia e Artit të menduarit.)
4.	IV	Procesi i të menduarit kritik dhe të shkruarit (Ky leksion ka për synim të qartësoj se, në fakt procesi i të shkruarit është rezultat i mendimeve tona, i ndërtimit të hartës konceptuale në mendjen tonë, si rezultat i leximeve të thella dhe i hulumtimit të ideve...)
5.	V	Pyetjet e kërkimit shkencor, hipotezat, përkufizimet operative të

		hulumtimit në komunikime.
6.	VI	Planifikimi i një projekti i hulumtimit në komunikime . Përkufizimi, aspekte praktike.
7.	VII	Kollekfiumi I
8.	VIII	Vlerësimi kritik i literaturës. Kërkimi i literaturës. Aspekte praktike të shqyrtimit të literaturës. Procesi i shqyrtimit të literaturës
9.	IX	Modelet e hulumtimit. Modeli cilësor dhe modeli sasior. Niveli dhe njësia e kërkimit shkencor. Strategjitë e kërkimit shkencor.
10.	X	Mbledhja e të dhënave. Pyetësorët, intervistat gjysmë të strukturuar
11.	XI	Grupet e fokusit. Vrojtimi. Burimet dytësore të të dhënave.
12.	XII	Analiza e të dhënave. Tiparet e analizës. Analiza statistikore. Analiza tematike. Puna me të dhëna cilësore. Analiza e rrëfimeve. Analiza e ligjërimit. Analiza e përmbajtjes
13.	XIII	Planifikimi dhe struktura e shkrimit akademik. Mënyra e të shkruarit
14.	XIV	Referencat në shkrimin akademik - Parimet e të cituarit. Plagjiatura.
15.	XV	Kollekfiumi II
Provimi përfundimtar		

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik i prezantuar 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e parapara:

- të respektojë orarin e ligjëratave;
- të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi;
- të mos mbajë të kyçur celular, apo aparate tjera gjatë orëve të mësimi.

Literatura obliguese:

1. Ligjëratat përgatitura nga Prof.ass. Dr. Rexhep Suma
2. Safet Zejnullahu, Shkrimi dhe komunikimi, UBT, Prishtinë,2014.
3. Mid'hat Shamiç, Si të shkruhet vepra shkencore, Logos-A, Shkup,2006.
4. Bob Matthews, Liz Ross (CDE 2010). Metodatat e Hulumtimit - Udhëzues Praktik për shkencat sociale dhe humane.
5. Kathleen McMillan dhe Jonathan Weyers, Si të shkruajmë ese dhe detyra universitare, Qendra për- Arsim Demokratik, Tiranë, 2014.
6. Vehbi Miftari, Teknikat themelore të shkrimit, IMP, Prishtinë,2009.
7. Bardhyl Musai, Si të shkruajmë ese (paragrafët, pyetjet dhe vlerësimi), Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2014.
8. Jill Lewis, Studimi akademik. CDE, Tiranë, 2005.
9. Bernard Zeneli, Sonila Danaj, Shkrim akademik, Ufopress, Tiranë.

Literatura shtesë:

- Umberto Eco, Si shkruhet një punim diplome, Dituria, Tirane, 2006.
- Manjola Zaçellari, Suela Kastrati. Shkrimi Akademik. Mileniumi i Ri,Tiranë,2017.
- Sylvan Barnet, Pat Ballanca, Marcia Stubbs, Shkrimi Akademik, botoi Dita, 2008.

- Literaturae preferuar:

- Elona Boce, Si të shkruajmë një punim kërkimor, Tiranë, 2004.
- Studio gjithçka, arsyes vendi i parë – zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit (Grup autorësh), Tiranë, 1998.
- Zejnullah Rrahmani, Si të shkruhet disertacioni, Prishtinë, 2001.
- Liljana Elmazi & Bajrami Hasani, Metodatat e kërkimit, 2009.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/ punë në laborator/ ushtrime	-	-	-
Punë praktike	1	15	15

Përgatitje për test intermediar	-	-	-
Konultime me mësime të mësuara	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	2
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)			3
Përgatitja përfundimtare për provim.			4
Koha e vlerësimit (teste, ese, provim final)			3
Totali			75